

AKTIVITETET E INSTITUTIT TË HISTORISË “ALI HADRI” GJATË VITIT 2025

Gjatë vitit 2025, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, në bashkëpunim me institucione kërkimore-shkencore dhe të arsimit të lartë nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Turqia, organizoi një numër të konsiderueshëm aktiviteteve shkencore. Gjatë këtij viti u realizuan gjithsej 13 aktivitete, që përfshinë:

- Konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Tryeza shkencore;
- Promovime;
- Ekspozitë;
- Ligjëratë.

KONFERENCAT SHKENCORE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

Konferenca shkencore: “Diaspora shqiptare dhe çështja e Kosovës 1912-2008”

Më 3 dhe 4 qershor 2025, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë - Institutin e Historisë, Tiranë, dhe Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup, organizoi konferencën shkencore ndërkombëtare me temën: **“Diaspora Shqiptare dhe Çështja e Kosovës 1912-2008”**. Konferenca pati si synim të trajtojë rolin dhe ndikimin e diasporës shqiptare në zhvillimet historike, politike dhe shoqërore që lidhen me çështjen e Kosovës gjatë periudhës 1912-2008. Pjesëmarrësit, ekspertë dhe studiues nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, dhe vende të tjera, diskutuan mbi çështje të rëndësishme historike, strategjite e lobimit të diasporës, ndikimin politik dhe kulturor, si dhe marrëdhëniet ndërkombëtare që kanë shënuar këtë periudhë. Ky aktivitet shkencor përbën një hap të rëndësishëm në thellimin e hulumtimeve mbi rolin e diasporës shqiptare dhe kontribuon në pasurimin e njohurive mbi historinë e

Kosovës dhe përpjekjet për çështjet kombëtare të shqiptarëve gjatë shekullit të 20-të dhe fillimit të shekullit 21-të.

Në këtë Konferencë u lexuan këto kumtesa: Arbër HADRI, Roli i diasporës shqiptaro-amerikane për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës; Hamit KABA, Emigracioni shqiptar në SHBA gjatë Luftës së Ftohtë: raportet me vendin e lindjes dhe të origjinës; Frashër DEMAJ, Emigrimi i arbëreshëve në Itali dhe ndikimi i tyre në ngritjen e vetëdijes kombëtare në fillet e Rilindjes; Eduart CAKA, Nga mërgata në diasporë: Shqiptarët e Egjiptit dhe diaspora shqiptare në Amerikë; Sali KADRIA, Kolonia shqiptare e Egjiptit dhe pikëpamjet e përfaqësuesve të saj për çështjen kombëtare; Muhamedin KULLASHI, Prizmat e trajtimit të çështjes së Kosovës në Francë; Besnik KRASNIQI, Kontributi i diasporës në ekonominë e Kosovës; Ledia DUSHKU, Atdheu përtej kufijve: diplomacia e diasporës dhe strategjitë e mobilizimit kombëtar (1912-1920); Mentor HASANI & Bleart THAÇI, Emigracioni shqiptar në SHBA (1900-1939): një analizë historike dhe demografike sipas burimeve amerikane; Marenglen VERLI, Konferenca e Paqes e Parisit dhe qëndrimet e diasporës dhe komitetit “MKK” për çështjen e Kosovës; Rudina MITA & Eva TAFILI-HYSKAJ, Pjesëmarrja dhe lobimi i përfaqësive shqiptare të Diasporës në Konferencën e Paqes së Parisit (1919); Romeo GURAKUQI, Delegacionet e Qeverisë së Durrësit dhe Qeverisë së Tiranës në bisedimet e paqes në Paris 1919-1921; Beqir META, Qëndrimi i Federatës Panshqiptare Vatra ndaj zhvillimeve në Shqipëri në vitin 1921; Elmi BERISHA, Kontributi i VATRA-s për çështjen e Kosovës; Ibrahim GASHI & Kosovar ALIJA, Suprimimi i autonomisë së Kosovës (1989) - uvertyrë e rrënimit ekonomik dhe shpërnguljes; Izet MIFTARI, Shkaqet dhe pasojat e shpërnguljes së shqiptarëve gjatë viteve 1912-1913; Erarba ÇIRAKU, Dokumentet diplomatike italiane për dëbimin dhe masakrat serbo-malazeze ndaj popullsisë shqiptare 1912-1913; Armend MEHMETI, “The adriatic review” - promotorë në sensibilizimin e opinionit publik dhe politik amerikan mbi çështjen shqiptare gjatë viteve 1918-1919; Haxhi ADEMI, Shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova gjatë viteve 1918-1941; Ilirjana KACELI (DEMIRLIKA), Roli i shtypit shqiptar në Turqi, në ruajtjen e identitetit kombëtar dhe përhapjen e ideve patriotike; Bendis KRAJA, Çështja e Kosovës në vëmendjen e “Vatrës” dhe të “Diellit”; Gjon BORIÇI, Problematika të diasporës dhe emigracionit politik shqiptar në periudhën e Luftës së Ftohtë 1945-1959; Marenglen KASMI, Emigracioni politik shqiptar dhe qëndrimi i tij ndaj çështjes së Kosovës (1945-1990); Qerim LITA & Sabit SYLA, Emigrimi shqiptar nga Kosova në

Evropën Perëndimore (1965-1980); Teki KURTI, Shteti shqiptar frymëzim për grupet politike në Kosovë dhe diasporë 1945-1997; Minir ADEMI, Kontributi i diasporës shqiptare në Zvicër për luftën çlirimtare në Kosovë (1998-1999); Teuta AGAI-DEMJAHA, Kontributi i diasporës shqiptare në Zvicër për shtetin mikpritës; Nail DRAGA, Diaspora e shqiptarëve të Malit të Zi në SHBA; Skender ZHITIA, Roli i fondit “Vendlindja thërret” në Luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës; Sabile KEÇMEZI-BASHA, Shtypi i diasporës shqiptare mbi situatën politike në Kosovë gjatë dhe pas demonstratave studentore të vitit 1981; Lumnije KADRIU, Ruajtja e identitetit kombëtar në diasporën shqiptare; Isak SHERIFI, Roli i mërgatës shqiptare në lëvizjen politike të vitit 1981-1989; Emrush XHEMAJLI, Demonstratat e diasporës shqiptare për sensibilizimin e çështjes së Kosovës; Naser RUGOVA, Kontributi i LDK-së në diasporë gjatë viteve 90 të; Jorina VERLI, Emigracioni politik dhe diaspora për çështjen e Kosovës midis dy luftërave botërore - rasti Bedri Pejani; Ibish NEZIRI, Shtypi i mërgatës shqiptare pas demonstratave të vitit 1968 dhe roli i tij në informimin e mërgimtarëve; Shkodran IMERAJ, Shpërnguljet e shqiptarëve gjatë luftës në Kosovë 1998-1999. Jeton ARIFI, Kontributi i diasporës shqiptare në Gjermani për luftën në Kosovë; Naim DE-DUSHAJ, Roli i personaliteteve shqiptaro-amerikane dhe LDK-së për çështjen e Kosovës; Fatmir ARIFI, Kontributi i Kadri Zekës, Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës në mërgatë për bashkimin e organizatave të fshehta me karakter çlirimtar; Sadik KRASNIQI & Besnik RACI, Kontributi i diasporës shqiptare në Australi për Kosovën; Qazim NAMANI & Emin SALLAHU, Kontributi i diasporës shqiptare në ruajtjen e identitetit kombëtar dhe aktivitetëve kulturore e politike gjatë viteve (1970-2000); Nurfi LEKAJ, Organizimi dhe veprimtaria e diasporës shqiptar në Norvegji 1987-2008. Saime ISUFI, Historiku i Lidhjes së Arsimitarëve dhe Prindërve Shqiptarë në Zvicër; Donika AVDULLI, Roli i grave shqiptare në diasporë në lobimin politik dhe kulturor për Kosovën (1990-2008); Bedri MUHADRI, Kontributi i “Unionit të Shqiptarëve në Kroaci” gjatë luftës në Kosovë 1998-1999; Ibrahim XHEMAJLI, Kontributi i radios “Zëri i Kosovës” në Danimarkë për informim dhe ndërgjegjësim të diasporës shqiptare në Evropë; Behar HYSENI, Roli i diasporës shqiptare në Rumani në ngritjen e nacionalizmit shqiptar.

Konferenca shkencore: “Transformimet dhe zhvillimi i qendrave urbane në trevat shqiptare”

Më 26 shtator 2025, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, në bashkëpunim me Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës-Departamentin e Historisë, organizoi Konferencën shkencore: **“Transformimet dhe zhvillimi i qendrave urbane në trevat shqiptare”**. Ky aktivitet solli së bashku historianë dhe arkeologë për të diskutuar strukturën, transformimet dhe ndikimet kulturore, ekonomike e politike që formuan qendrat urbane shqiptare. Konferenca synoi të hulumtojë dhe të vlerësojë proceset historike që ndikuan në formimin dhe zhvillimin e qyteteve dhe qendrave urbane në hapësirat shqiptare gjatë antikitetit të vonë dhe mesjetës. Ajo ofroi një platformë për studies, historianë dhe arkeologë që të ndajnë gjetjet dhe analizat e tyre lidhur me transformimet dhe zhvillimin e qendrave urbane në trevat shqiptare.

Në këtë konferencë me kumtesa u paraqitën: Jahja DRANÇOLLI, Zhvillimi i jetës konsullore në qytetet e Kosovë 1332-1455; Muhamet MALA, Përbërja etnike e qyteteve të Arbërisë së Mesme dhe Veriore gjatë shekujve XIV-XV; Emine HAJDARI, Transformimet urbane në Dardani gjatë antikitetit të vonë: ndikimi i invazioneve barbare në ripërkufizimin e qendrave urbane (shek.IV-VI); Arben HAJDARI & Christophe J. GODDARD & Milot BERISHA, The Evolution of Urban Spaces: Urban Planning and Public Architecture from Ulpiana to Justiniana Secunda; Paulin PUSHIMAJ, Territori i Postribës nga prehistoria në mesjetë: vëzhgime topografike dhe dinamika e popullimit; Kujtime BOSHTRAKAJ-CAMAJ, Zhvillimi i arkitekturës paleokrishtere në qytete të Dardanisë; Qerim DALIPI, Ohri gjatë shek. XI-XIV (aspekte politike-ekonomike); Arben ARIFI, Pushtimet barbare në Dardani dhe shkatërrimi i qendrave urbane; Elfat SULIMANI, Fortesat mesjetare në Pollog (shek. XI-XIV). Alvin SARAÇI, Qendra urbane e Durrësit dhe ruajtja e trashëgimisë arkitekturore nga antikiteti në mesjetë; Etleva LALA, Vitruvius dhe arkitektura e qyteteve mesjetare arbërore; Muhamet GLLOGJANI & Fidan ZENELI, Durrësi gjatë mesjetës së hershme; Edmond MALAJ, Rreth zhvillimit urban të Shkodrës gjatë mesjetës dhe shekujve të parë të pushtimit osman; Ardian MUHAJ, Qyteti mesjetar në hapësirën shqiptare: një shqyrtim tipologjik dhe kronologjik; Ermal BAZE, Profili italo-dalmatin i qytetit të Shkodrës në fillim të mesjetës së vonë; Bedri MUHADRI, Prizreni qytet i tregtarëve në shek. XIII-XV; Durim ABDULLAHU, Episode nga jeta e përditshme e arbërve në qytete; Teuta SHALA-PELI, Pozita e gruas në shoqëri dhe familje: analizë nga statutet e Shkodrës, Drishtit dhe burimet tjera të

kohës; Evalda PACI, Burime e të dhëna dokumentare mbi figura të rëndësishme të historisë kishtare të shekullit XVII.

Konferenca shkencore: “Krizja Lindore 1875-1878 dhe Shqiptarët”

Më 24 tetor 2025, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë-Institutin e Historisë, organizoi Konferencën shkencore: “**Krizja Lindore 1875-1878 dhe Shqiptarët**”. Konferenca trajtoi ndikimet e krizës lindore në trevat shqiptare, duke ofruar një mundësi për studiues të historisë për të diskutuar zhvillimet politike, shoqërore dhe diplomatike të periudhës.

Në këtë konferencë me kumtesa u paraqitën: Frashër DEMAJ, Roli i Britanisë së Madhe në Krizën Lindore 1875-1878; Ledia DUSHKU, Kriza Lindore dhe bashkëpunimi ballkanik: midis interesave të përbashkëta dhe kufizimeve nacionaliste (1875-1878); Beqir META, Nacionalizmi shqiptar në Shqipërinë e Epërme gjatë viteve 1879-1880; Ibrahim GASHI, Gjeopolitika e re e Ballkanit pas Luftës Ruso-Osmane 1877-1878 dhe shqiptarët; Marengelen VERLI, Vlerësimi i shqiptareve nga Austro-Hungaria si aleate potenciale në koniukturat e krijuara në kuadër të Krizës Lindore; Agron ISLAMI, Aspekte politike dhe ushtarake në suaza të Krizës Lindore 1875-1878: Dhunë, shpërngulje dhe uzurpim i pasurive të shqiptarëve në sanxhakun e Nishit; Sali KADRIA, Interesimi i diplomacisë franceze për krahinën e Mirditës gjatë viteve të krizës lindore në vitet ‘70 të shek. XIX; Kurt GOSTENTSCHNIGG, Roli sekret dhe fatal i Ludwig Thallóczy-it në kryengritjen e Malësisë së Madhe 1883 si pasojë e Krizës Lindore; Esmeralda KOLANECI, Çështja shqiptare në kontekstin e Krizës Lindore dhe interesave të Fuqive të Mëdha; Mentor HASANI & Behar HYSANI, Lufta ruso-osmane (1877-1878) dhe rikonfigurimi politik i Ballkanit; Erjon PAPAGJONI, Tokat shqiptare - midis osmanëve dhe evropianëve 1876-1878; Donika AVDULLI, Realpolitika e re gjermane ndaj shqiptarëve dhe Ballkanit në periudhën e Krizës Lindore; Izet MIFTARI, Rrethanat socio-ekonomike në prag të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Konferenca shkencore: “Dimensioni historik i kufijve të Kosovës nga Antika deri në kohë bashkëkohore”

Më 21 nëntor 2025, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, në bashkëpunim me Institutin Albanologjik, organizoi Konferencën shkencore: **“Dimensioni historik i kufijve të Kosovës nga Antika deri në kohë bashkëkohore”**. Konferenca solli së bashku studiues të fushave të ndryshme, për të diskutuar mbi zhvillimet historike të kufijve të Kosovës, ndikimet politike dhe kulturore, si dhe interpretimet e ndryshme historike nga periudha antike deri në ditët e sotme. Në këtë konferencë me kumtesa u paraqitën: Arbër HADRI, Dimensioni historik i përcaktimit të kufijve bashkëkohorë të Kosovës; Jahja DRANÇOLLI, Burimet tregimtare antike greke dhe romake për kufijtë e Dardanisë; Emine HAJDARI, Kufijtë e Dardanisë në burimet antike; Premtim ALAJ & Sedat BARALIU, Proceset e konsolidimit dhe zgjerimit të Mbretërisë Dardane; Arben HAJDARI & Ilir CULAJ, Dardanët dhe Mezia: rruga drejt krijimit të Provincës së Dardanisë; Arben ARIFI, Terriotori i Dardanisë nën administrimin e Republikës dhe Perandorisë Romake; Gazmend RIZAJ, Delimitacioni i kufirit osmano-serb (1878-1879); Mead OSMANI, Kongresi i Berlinit dhe ndryshimi i kufijve të Vilajetit të Kosovës; Jusuf OSMANI, Dokumente arkivore për caktimin e kufijve (1878-1879); Izet MIFTARI, Formimi dhe shtrirja e Vilajetit të Kosovës (1877-1912); Skender LUTFIU, Organizimi administrativ i trevave shqiptare (1913-1941); Fitim RIFATI, Përplasje aleatësh për kufijtë administrativë në Kosovë gjatë Luftës së Parë Botërore; Armend MEHMETI, Reforma administrative e vitit 1929 në Mbretërinë e Jugosllavisë; Nuridin AHMETI & Shpend AVDIU, Kujtesa kolektive rreth aspekteve kufitare në Opojë dhe Gorë (1945-1966); Haxhi ADEMI & Bleart THAÇI, Ndarja e kufijve dhe zonave të influencës në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore; Sabile KEÇMEZI-BASHA, Rikonfigurimi historiko-politik i Kosovës pas vitit 1945; Vullnet ISENI, Ndikimi i faktorëve të huaj mbi gjendjen e sigurisë në RSFJ; Shpejtim BULLIQI & Hamit BASHOLLI, Evolucionin dhe ndryshimet e kufijve të Kosovës (1943-2025); Mrika LIMANI-MYRTAJ, Kufiri politik dhe ideologjik të shqiptarët në vitet '70; Skender ZHITIA, Marrëveshja e Kumanovës dhe delimitimi ushtarak-politor i Kosovës. Fatmir ARIFI & Albulena HALILI, Koncepti i kufijve dhe tkurrja e tyre në hapësirën shqiptare; Ilir ZYLFIU, Lugina e Preshvës në raport me kufijtë e Kosovës; Nail DRAGA, Kufiri si simbol ndarjeje për shqiptarët në Mal të Zi; Adil OLLURI, Rrëfimi për kufirin në romanet e Hajdar Salihut; Dorina DAIU & Florinka GJEVORI, Divegjencat shqip-

tare për kufijtë në periudhën e Luftës së Dytë Botërore; Ardian RAMADANI & Minir ADEMI, Kufijtë në relacion me identitetin dhe kulturën kombëtare shqiptare; Tomor ÇELA, Territori dhe sipërfaqja e Kosovës (1958-2018).

Konferenca shkencore ndërkombëtare: “Identitete religjioze në trojet shqiptare nga Mesjeta deri në rënien e Perandorisë Osmane”

Më 29 shtator 2025, Akademia e Shkencave e Shqipërisë - Instituti i Historisë, në bashkëpunim me Institutin e Historisë “Ali Hadri”, organizuan në Tiranë Konferencën Shkencore Ndërkombëtare: **“Identitete religjioze në trojet shqiptare nga Mesjeta deri në rënien e Perandorisë Osmane”**. Konferenca trajtoi zhvillimet historike, sociale dhe kulturore që kanë formësuar identitetet religjioze në trojet shqiptare gjatë periudhës mesjetare, deri në rënien e Perandorisë Osmane.

Në këtë konferencë me kumtesa u paraqitën: Kujtime BOSHTRAKAJ-CAMAJ, Identiteti kulturor përmes simboleve: Simboli i Diellit, Hënës dhe Kryqit në tatuazhet e grave shqiptare; Paulin PUSHIMAJ, Të dhënat e burimeve historike dhe dëshmitë arkeologjike për Ipeshkvinë e Drishtit; Teuta SHALA-PELI, Organizimi i jetës kishtarë në qytetin e Drishtit sipas statuteve të këtij qyteti; Edmond MALAJ, Urdhri Françeskan në trojet arbërore gjatë Mesjetës dhe periudhës së Perandorisë Osmane; Alvin SARAÇI, Kontributi i Urdhrit Françeskan në Shqipëri në shek. XVII dhe në gjysmën e parë të shek. XVIII; Arben ARIFI & Luan TETAJ, Ortodoksia në Kosovë dhe roli i saj gjatë Mesjetës; Orges DRANÇOLLI, Xhamia e Sofi Sinan Pashës në Prizren: Arkitektura dhe dekoracionet; Nertila LJARJA & Gjovalin ÇUNI Bektashizmi shqiptar – simbol i sinkretizmit islamik-të krishterë dhe tolerancës fetare; Konstantinos GIAKUMIS, Piramidat e identifikimit dhe identiteti i krishterë ortodoks në rajonet shqipfolëse të Ballkanit Perëndimor nga periudha e vonë mesjetare deri në fund të Perandorisë Osmane; Vështrime nga vetidentifikimet individuale dhe kolektive; Gjon BERISHA, Roli i misionarit dhe argjipeshkvit të Tivarit, Fran Leonardit, në përpjekjet për bashkim (uniatizëm) me kishën ortodokse në shek. XVII; Agron ISLAMI, Fenomeni i shndërrimit të mesxhideve në xhami në trevën e Kosovës gjatë shekujve XVII-XVIII: një reflektim i procesit të islamizimit; Andi REMBECI, Esnafët dhe kisha: Organizimi i jetës ekonomiko-religjioze në Korçë gjatë shekujve osmanë XVIII-XIX; Eduart CAKA, Elitat shqiptare në shek. XV dhe ndikimi i tyre në procesin e islamizimit; Bendis KRAJA & Ilirjana KACELI, Elita fetare myslimane në Shkodër gjatë Perandorisë Osmane: Figura, instituci-

one dhe ndikimi shoqëror; Ardian MUHAJ, Objekte fetare të devotshmërisë të ngritura nga shqiptarët në botën mesdhetare dhe osmane; Nail DRAGA, Hafiz Ali Ulqinaku, personalitet i veçantë i Rilindjes Kombëtare në Ulqin; Hasan BELLO, Lëvizja protestante në vilajetet shqiptare nga fundi i shek. XIX deri në fillim të shek. XX; Simon LUFİ & Marsel NILAJ, Kisha katolike, katolikët në Perandorinë Osmane gjatë shek. XIX sipas historiografisë Botërore.

Konferenca shkencore ndërkombëtare: “Kosova dhe Diplomacia Ndërkombëtare: Histori, sfida dhe perspektiva (fondi i shek. XX dhe fillimi i shek. XXI)”

Fakulteti Filozofik i Universitetit të Prishtinës-Departamenti i Historisë, në bashkëpunim me Institutin e Historisë “Ali Hadri” dhe Institutin Albanologjik - Prishtinë, më 15 tetor 2025, organizuan Konferencën Shkencore Ndërkombëtare: **“Kosova dhe Diplomacia Ndërkombëtare: Histori, sfida dhe perspektiva (fondi i shek. XX dhe fillimi i shek. XXI)”**. Konferenca u mbajt në Prishtinë dhe mblodhi ekspertë të marrëdhënieve ndërkombëtare, historianë, diplomatë dhe përfaqësues institucionesh akademike. Qëllimi i saj ishte të trajtojë ndërveprimet e Kosovës me faktorin ndërkombëtar gjatë fund-shekullit XX dhe fillim-shekullit XXI, si dhe të analizojë sfidat diplomatike, proceset politike dhe perspektivat e së ardhmes. Konferenca u vlerësua për qasjen e saj ndërdisiplinore dhe kontributin në pasurimin e debatit akademik mbi proceset diplomatike që kanë ndikuar formësimin e shtetësisë së Kosovës. Punimet e konferencës filluan me Panelin e diskutimit, në të cilin kontribuan personalitete me përvojë të gjatë në diplomacinë kosovare: Avni Spahiu - Diplomat nga Republika e Kosovës; Enver Hoxhaj - Ish-ministër i Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës dhe Fitim Gllareva - Diplomat nga Republika e Kosovës. Paneli hapi diskutimin mbi zhvillimet kryesore të politikës së jashtme të Kosovës, rolin e diplomacisë në konsolidimin e shtetësisë, sfidat e përfaqësimit ndërkombëtar dhe perspektivat strategjike në raport me partnerët globalë dhe rajonalë.

Gjatë sesioneve të punës u prezantuan këto kumtesa: Ibrahim GASHI, Diplomacia para bombave: Fushata diplomatike e Grupit të Kontaktit në Kosovë (1997-1999); Bujar DUGOLLI, Diplomacia ndërkombëtare ndaj çështjes së Kosovës në procesin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë; Arbër HADRI, Ushtria Çlirimtare e Kosovës: Lufta e armatosur dhe qëndrimi i SHBA-së dhe Mbretërisë së Bashkuar (1998-1999); Hasan BELLO, Koso-

va në optikën e diplomacisë amerikane në vitet '80: Kontributi i senatorit Jesse Helms; Adem BEHA, Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë nëpërmjet një leximi kantian: përtej paradigmave realiste dhe idealiste; Anton PANCHEV, Politika e Bullgarisë ndaj Kosovës në shekullin XXI; Hysen MATOSHI, Mërgata shqiptare në Evropën Perëndimore përballë diplomacisë jugosllave; Mentor HASANI & Shpresa RAMA, Krimet e Serbisë në Kosovë dhe ndikimi i tyre në diplomacinë evropiano-perëndimore: Rast studimi, masakra e Reçakut; Nuridin AHMETI, Roli i institucioneve shkencore në Kosovë për sensibilizimin e çështjes kombëtare në Jugosllavi gjatë viteve '90 të shekullit XX; Albina DRANÇOLLI-RAMADANI, Gjinia dhe politika gjatë viteve të sistemit paralel në Kosovë; Sylë UKSHINI, Njohja e Kosovës nga vendet e BE-së dhe vendimi i GJND-së; Kujtime BOSHTRAKAJ-CAMAJ, Kontributi humanitar i shoqatës “Nënë Tereza” në Kosovë gjatë viteve 1990-1999; Skender LUTFIU, Qëndrimi i Bashkimit Evropian në procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë: Rasti i Kosovës; Dorajet IMERI, (Pa)krahueshmëria në procesin e njohjes së shtetësisë së Kosovës dhe Palestinës: Gjeopolitika dhe dinamikat; Haxhi ADEMI, Qëndrimi i diplomacisë shqiptare ndaj shpërbërjes së Jugosllavisë dhe çështjes së Kosovës në fillim të viteve '90; Ramadan AVDIU, Roli i grupit diplomatik të UÇK-së në legjitimimin ndërkombëtar të luftës çlirimtare; Armend MEHMETI, Kriza jugosllave në rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara: Rasti i Kosovës; Skender ZHITIA, Marrëveshja e Kumanovës dhe vendimet ushtarako-tekniqe: Një analizë politiko-ushtarake; Shkodran IMERAJ, Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së - Administrimi ndërkombëtar i Kosovës (1999- 2008); Izet MIFTARI, Rezistenca gjithëpopullore në Kosovë (1989- 1991) dhe reflektimet e saj në diplomacinë perëndimore; Iliriana KACELI-DEMIRLIKA & Lirije KURTISHAJ-ADEMI, Politikat diskriminuese ekonomike dhe ndikimi i tyre në jetën shoqërore të shqiptarëve të Kosovës në fillim të viteve '90; Fahrush REXHEPI, Roli i Turqisë dhe qëndrimi i vendeve të Ligës Arabe ndaj pavarësisë së Kosovës; Miftar KURTI, Roli determinues i Këshillit të Atlantikut të Veriut për çlirimin e Kosovës (1998-1999); Oktaj HASANI & Albin HALIMI, Diaspora shqiptare dhe çështja e Kosovës gjatë viteve '90: Ndasitë dhe pikëtakimet; Albulena HALILI & Fatmir ARIFI, Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë dhe origjina e R2P: Narrativat diplomatike të SHBA-së dhe BE-së mbi një rast sui generis; Dorina DAIU, Kosova në riorganizimin e fundit të Jugosllavisë: Ndërmjet federalizmit, konfederalizmit dhe aspiratave për shtetësi; Behxhet GASHI, Konferenca e Rambujes (shkurt-mars 1999) në

shtypin frankofon: Evropa dhe Kanadaja; Donika AVDULLI, Diskursi i diplomacisë serbe për mohimin e krimeve në Kosovë - Rast studimi: Shkrimet serbe për masakrën e Reçakut.

TRYEZAT SHKENCORE

Tryeza shkencore: “Ballafaqimi me të Kaluarën: Burimet, Programet dhe Pedagogjia (1990-1999)”

Më 7 maj 2025 u mbajt Tryeza shkencore: “**Ballafaqimi me të Kaluarën: Burimet, Programet dhe Pedagogjia (1990-1999)**”, e organizuar nga Instituti i Historisë “Ali Hadri”, në bashkëpunim me Institutin Pedagogjik të Kosovës, dhe Fondi për të Drejtën Humanitare. Në këtë tryezë u prezantuan rezultate kërkimore, qasje metodologjike dhe analiza profesionale lidhur me periudhën 1990-1999, me fokus në burimet historike, programet edukative dhe dimensionin pedagogjik. Pjesëmarrësit kontribuan me diskutime të vlefshme, duke nxjerrë përfundime të rëndësishme për studimet e mëtejshme dhe për qasjen e institucioneve ndaj kësaj periudhe.

Tryeza ishte e ndarë në dy Panele. Në Panelin e parë, me temë: “**Ballafaqimi me të kaluarën, dokumentimi dhe kujtesa kolektive**”, kontribuan: Arbër Hadri-Sekretar shkencor i Institutit të Historisë “Ali Hadri”; Atdhe Hetemi - Drejtor i Institutit për Krimet e Kryera në Kosovë; Bekim Baliqi - Dekan i Fakultetit Filozofik, Universiteti i Prishtinës; Bekim Blakaj - Përfaqësues i Fondit për të Drejtën Humanitare (FDH) Kosovë.

Në Panelin e dytë, me temë: “**Inkuadrimi i ballafaqimit me të kaluarën në edukimin formal**”, kontribuan: Murteza Osdautaj - Sekretar shkencor, Instituti Pedagogjik i Kosovës; Veli Kryeziu - Fakulteti i Edukimit. Haxhi Ademi - Shef i departamentit të Historisë Bashkohore- Instituti i Historisë. Tryeza u vlerësua për kontributet e saj profesionale dhe për thellimin e dialogut ndërinstitutional rreth trajtimit të së kaluarës së afërt dhe integritetit të saj në sistemin arsimor dhe në studimet historike.

Tryeza shkencore: “Shemsettin Sami Frashëri dhe lëvizjet moderne turko-shqiptare”

Më 10 tetor 2025, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, në bashkëpunim me Institutin e Historisë së Turqisë *Türk Tarih Kurumu*, zhvilluan tryezën shken-

core: “**Shemsettin Sami Frashëri dhe lëvizjet moderne turko-shqiptare**”. Ky aktivitet mblodhi studiues nga Kosova dhe Turqia për të trajtuar figurën shumëdimensionale të Shemsettin Sami Frashërit dhe rolin e tij në proceset e modernizimit, identitetit dhe kulturës shqiptare dhe turke. Gjatë sesioneve u prezantuan katër kumtesa: Yüksel TOPALOĞLU, *Shemsettin Samiu në kontekstin e çështjes së identitetit dhe përkatësisë*; Agron ISLAMI, *Shemsettin Sami Frashëri dhe kontributi i tij për çështjen kombëtare shqiptare gjatë viteve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*; Mustafa BALCI, *Mbi veprat e fundit të Sh. Samiut*; Alban DOBRUNA, *Sufizmi në veprat e Sami Frashërit*. Aktiviteti shënoi një kontribut të rëndësishëm në studimet ndërdisiplinore mbi Sami Frashërin, duke nxitur diskutime mbi proceset e modernizimit dhe formësimin e identitetit kombëtar.

PROMOVIMET

Promovimi i botimeve të Institutit të Historisë “Ali Hadri”, prill 2024-prill 2025

Më 18 prill 2025, Instituti i Historisë “Ali Hadri” organizoi ceremoninë e promovimit të botimeve shkencore për periudhën prill 2024 - prill 2025. Në këtë aktivitet, Instituti promovoi 16 botime, të cilat trajtojnë çështje historike kombëtare dhe ndërkombëtare, duke përfshirë diplomacinë, lëvizjet politike, lëvizjet kundërshtuese, dokumentet historike dhe përfaqësimet e ngjarjeve historike nga autorët antikë. Çdo libër u prezantua nga referues të fushave përkatëse, të cilët ofruan analiza të detajuara dhe diskutime mbi rëndësinë shkencore dhe metodologjike të librave. Promovimi u vlerësua si një ngjarje e rëndësishme shkencore, që dëshmon angazhimin e Institutit në botimin e studimeve.

Gjatë promovimit u paraqitën këto botime:

1. *Çështja shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër 1912-1913*, (Materiale nga Konferenca Shkencore, 26 tetor 2023), Prishtinë: Instituti i Historisë, 2024.
2. *Roli i grave në jetësimin e shtetit të Kosovës, Aspekte sociale, kulturore dhe politike nga viti 1980 deri në ditët e sotme*, (Materiale nga Konferenca Shkencore Ndërkombëtare, 5 maj 2023), Prishtinë: Instituti i Historisë, 2024.

3. *Konferenca e Bujanit - retrospektiva dhe rezultatet historike*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2024.
4. Revista shkencore “Kosova”, nr. 49, botim i Institutit të Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, 2024.
5. Arbër HADRI & Armend MEHMETI, *Marrëdhëniet jo zyrtare: Shtetet e Bashkuara dhe Qeveria revolucionare në Shqipëri-1924*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2024.
6. Frashër DEMAJ, *Shën Naumi dhe Vermoshi sipas burimeve diplomatike të Britanisë së Madhe (1925)*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2024.
7. Kosovar BASHA, *Qëmtime Historike*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2024.
8. Mrika LIMANI-MYRTAJ, *Përkohësia e lëvizjeve kundërshtuese në Kosovë 1941-1999*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2024.
9. Arbër HADRI, *Politika e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndaj çështjes së Kosovës: 1989-2008*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2024.
10. Ardita HAJDARI-BUQINCA, *Shtypi shqiptar për lëvizjet e armatosura në Kosovë (1908-1924)*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2024.
11. Miftar KURTI, *NATO për Kosovën (24 mars - 20 qershor 1999)*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2024.
12. Ibish NEZIRI, *Sahit Kastrati në luftë për çlirim dhe bashkim kombëtar*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2024.
13. Sabile KEÇMEZI-BASHA, *Ekzekutimi i shqiptarëve nga OZNA dhe UDB-ja jugosllave gjatë viteve 1944-1990*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2024.
14. Sabile KEÇMEZI-BASHA, *Top Sekret: Dëshmi për keqpërdorimet dhe deformimet e Shërbimit të Sigurimit Shtetëror Jugosllav në Kosovë (1945-1966)*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2024.
15. Emine HAJDARI & Arben HAJDARI, *Dardanët dhe Dardania: një histori e rrëfyer nga autorët antikë*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2025.
16. Alban DOBRUNA, *Asim Luzha*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2025.

Promovimi i librit: “Kosovo at War”

Më 17 shtator 2025, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, organizuan promovimin e librit: “Kosovo at War”, të fotoreporterit dhe autorit danez Thomas Sjørup. Ky aktivitet iu dedikua dokumentimit historik dhe vizual të luftës në Kosovë, përmes fotografive dhe rrëfimeve që pasqyrojnë realitetin e asaj periudhe të vështirë. Kontributi i Thomas Sjørup-it është i vlefshëm sepse dëshmitë e tij vizuale dhe rrëfimet që i shoqërojnë ato ofrojnë një këndvështrim ndërkombëtar mbi ngjarjet, duke ndihmuar në njohjen dhe kuptimin global të tragjediave që kanë prekur popullin e Kosovës. Një vepër e tillë jo vetëm që pasuron historigrafinë, por shërben edhe si mjet sensibilizimi ndërkombëtar, duke ruajtur kujtesën kolektive dhe duke forcuar narrativën e drejtë për luftën dhe pasojat e saj.

Për librin folën: Arbër Hadri, i cili prezantoi autorin Thomas Sjørup, duke ndriçuar karrierën e tij të gjatë si fotoreporter dhe punën e tij në zonat e luftës. Më pas, Mrika Limani-Myrtaj bëri paraqitjen analitike të librit, duke trajtuar përmbajtjen, mesazhin dhe rëndësinë historike të veprës, si një dëshmi autentike e ngjarjeve të luftës në Kosovë. Autori Thomas Sjørup mbajti fjalën e tij përshëndetëse, ku ndau përvojat personale, motivimin dhe sfidat e dokumentimit të luftës. Pas prezantimeve, u zhvillua një sesion diskutimesh me pjesëmarrësit, duke hapur hapësirë për reflektim rreth rolit të fotografisë në ruajtjen e kujtesës historike.

Promovimi i botimeve të Instituti i Historisë “Ali Hadri” në Prizren

Instituti i Historisë “Ali Hadri”, në bashkëpunim me Institutin Yunus Emre - Prizren, organizoi më 11 nëntor 2025, në qytetin e Prizrenit, promovimin e tri veprave të botuara nga Instituti i Historisë, Ky promovim mblodhi studiues, studentë, përfaqësues institucionesh dhe dashamirës të historisë. Në kuadër të këtij aktiviteti u prezantuan këto botime: Agron Islami, *Areali i Kosovës në kohën osmane (një histori socio-ekonomike e shekullit XVIII)*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2024; Orges Drançolli, *Xhamitë me Kube në Kosovë*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2023; Mead Osmani, *Sanxhaku i Nishit gjatë periudhës osmane (Shek. XIX)*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2022.

Ky aktivitet synoi të promovojë studimet shkencore mbi periudhën osmane në hapësirat shqiptare, duke i ofruar publikut një pasqyrë të pasur mbi zhvillimet socio-ekonomike, arkitekturën fetare dhe historinë administrative të rajonit. Të pranishmit patën mundësinë të njihen nga afër me përmbajtjen,

rëndësinë dhe kontributin e këtyre veprave në fushën e historiografisë shqiptare.

Promovimi i librit: “Medreseja e madhe në Shkup (1925-1941)”

Më 12 dhjetor 2025, në ambientet e Institutit të Historisë “Ali Hadri”, u mbajt promovimi i librit **“MEDRESEJA E MADHE NË SHKUP (1925–1941)”**, i autorit prof. dr. Izet Šabotić, botim i Qendrës për Hulumtimin e Historisë Moderne dhe Bashkëkohore – Tuzëll, Bosnjë dhe Hercegovinë. Aktiviteti u zhvillua në prani të studiuesve, profesorëve dhe bashkëpunëtorëve të Institutit të Historisë, të cilët theksuan rëndësinë shkencore të këtij botimi dhe kontributin e tij në ndriçimin e rolit të Medresesë së Madhe në zhvillimet kulturore, arsimore dhe shoqërore të Shkupit gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore.

Për librin folën prof. dr. Arbër Hadri, Sekretar Shkencor i Institutit të Historisë, akademik Jusuf Bajraktari, prof. dr. Jusuf Osmani dhe akademik Rexhep Shkrijel, të cilët vlerësuan qasjen metodologjike të autorit, përdorimin e burimeve arkivore dhe rëndësinë e studimit për historiografinë e arsimit dhe institucioneve fetare në hapësirën shqiptare dhe më gjerë. Në fund të aktivitetit, prof. dr. Izet Šabotić mori fjalën, duke prezantuar nga afër punën e tij kërkimore, sfidat gjatë hartimit të studimit dhe rëndësinë e Medresesë së Madhe si institucion arsimor e kulturor në kontekstin historik të kohës.

Ligjërata publike: “Diktatura, qyteti, arkivi: një udhërrëfyes”

Më 30 prill 2025, Heritage Space (CHwB Kosova), Fondacionet për Shoqëri të Hapur - Ballkani Perëndimor dhe Instituti i Historisë “Ali Hadri” organizuan ligjërata publike: **“Diktatura, qyteti, arkivi: një udhërrëfyes”**. Ky aktivitet u zhvillua me qëllim të reflektimit mbi marrëdhënien mes së kaluarës, hapësirës urbane dhe arkivave nën regjimet autoritare. Ligjërata u fokusua në rolin e arkivave si dëshmi historike dhe në ndikimin e politikave autoritare në zhvillimin e hapësirave urbane, duke nxitur diskutime mbi mënyrën se si kujtesa kolektive formësohet dhe ruhet përmes dokumenteve dhe hapësirave publike. Ligjërues i aktivitetit ishte Elidor Mëhilli, i cili prezantoi perspektiva teorike dhe praktike mbi marrëdhënien mes diktaturës dhe qytetit. Ligjërata u vlerësua si një mundësi e rëndësishme për edukim publik, duke ofruar njohuri dhe debat mbi trashëgiminë urbane dhe historike, si dhe mbi rolin e arkivave në dokumentimin dhe interpretimin e së kaluarës. Pjesëmarrësit, të përbërë nga studiues, studentë dhe profesionistë të fushës, patën mundësinë të disku-

tonin mbi rëndësinë e kujtesës historike në kontekstin e hapësirës urbane dhe ndikimin e politikave autoritare në dokumentimin e saj.

Ekspozita

Më 17 shtator 2025, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, organizuan ekspozitën me fotografi nga libri “*Kosovo at War*”, të realizuara nga fotoreporterit dhe autori danez Thomas Sjørup. Ekspozita u hap në hapësirat e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, duke e shndërruar këtë mjedis kulturor në një galeri të gjallë kujtese historike. Aktiviteti u zhvillua menjëherë pas përfundimit të programit zyrtar të promovimit të librit, duke i ofruar publikut një mundësi të drejtpërdrejtë për të parë dhe përjetuar imazhet tronditëse dhe njëkohësisht tejet domethënëse të luftës në Kosovë.

Fotografite e ekspozuara paraqisnin momente kyçe të luftës: jetën e përditshme gjatë luftës, dhunën dhe vuajtjet e civilëve, shpërnguljet masive, por edhe forcën, rezistencën dhe shpresën e popullit të Kosovës. Të pranishmit patën mundësinë të përjetonin një rrëfim të fuqishëm vizual që flet për sakrificat dhe qëndresën. Ekspozita u mirëprit nga studiues, studentë, dhe qytetarë të shumtë. Nëpërmjet punës së Thomas Sjørup-it, publiku u ballafaqua me një perspektivë objektive dhe ndërkombëtare të ngjarjeve, duke theksuar edhe një herë rolin jetik që kanë dëshmitë vizuale në ruajtjen e memories kolektive dhe në kuptimin e të kaluarës së afërt të Kosovës.

VEPRIMTARIA BOTUESE

Botimet e vitit 2025 pasqyrojnë orientimin strategjik të Institutit drejt realizimit të monografive shkencore, vëllimeve me punime shkencore, përmbledhjeve me kumtesa nga aktivitetet shkencore, si dhe publikimeve me dokumente arkivore me rëndësi për historiografinë shqiptare. Përmes këtyre botimeve, Instituti ka kontribuar në pasurimin e historiografisë sonë, duke i ofruar komunitetit akademik dhe publikut të gjerë materiale të reja me vlera të larta shkencore dhe dokumentare.

Gjatë vitit 2025 u botuan këto vepra të rëndësishme:

1. *Historia e Kosovës*, vëllimi I, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2025.

2. Emine HAJDARI & Arben HAJDARI, *Dardanët dhe Dardania: një histori e rrëfyer nga autorët antikë*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2025.
3. Alban DOBRUNA, *Asim Luzha*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2025.
4. *Kosova 1989-1999: organizimi dhe qëndresa për çlirim*, materiale nga Konferenca Shkencore (13-14 qershor 2024), Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2025.
5. *Shqiptarët dhe Lufta e Parë Botërore*, materiale nga Konferenca Shkencore Ndërkombëtare (25 tetor 2024), Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2025.
6. Fidan ZENELI, *Humanizmi dhe Rilindja evropiane tek arbërorët (shek. XV–XVII)*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2025.
7. Ibrahim GASHI, *Studime historike III*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2025.
8. Ibrahim GASHI, *Historical Studies IV*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2025.
9. Jeton IDRIZI, *Administrimi shqiptar në Kosovë gjatë viteve 1941–1944*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2025.
10. *Interesimi i Britanisë së Madhe për Gani Kryeziun (1945–1948)*, dokumente arkivore, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2025, përgatitur nga Kosovar BASHA.
11. Jahja DRANÇOLLI, *Raguzanët në Kosovë (prej fundit të shekullit XIII deri në vitin 1455)*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2025.

Ky korpus botimesh dëshmon konsolidimin e Institutit të Historisë “Ali Hadri” si një qendër e rëndësishme kërkimore në fushën e historisë, duke ofruar studime të mirëstrukturuara, analiza mbi bazën e burimeve të dorës së parë dhe qasje moderne metodologjike mbi periudha të ndryshme historike. Veprimtaria botuese e vitit 2025 përbën një kontribut të çmuar në dokumentimin, interpretimin dhe promovimin e trashëgimisë historike shqiptare, duke pasuruar më tej bazën shkencore për studimet e ardhshme.

Në proces botimi:

1. Shkodran IMERAJ, Suprimim i dhunshëm i Autonomisë së KSA të Kosovës.
2. Mrika LIMANI-MYRTAJ & Alban DOBRUNA, Politika e represionit dhe ekonomia e luftës në Kosovë dhe Jugosllavi gjatë pushtimit nazist

- (1941-1944): një analizë dokumentare e burimeve gjermane arkivore (dokumente gjermane).
3. Arbër HADRI, Lufta në Kosovë 1998-1999: Qëndrimi i Mbretërisë së Bashkuar (Vëllimi I-1998) & (Vëllimi II-1999).
 4. Haxhi ADEMI, Kosova në Dokumentet e Arkivit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë 1990-1991.
 5. Haxhi ADEMI & Lumturie KURTISHAJ-SOPA, Pasqyrimi i gjendjes në Kosovë në fundvitet ‘80 sipas dokumenteve të Arkivit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë.
 6. Selim DACI, Veprimtaria ekonomike e qyteteve të Kosovës në mesjetë shekujt XII-XV
 7. *Historia e Kosovës*, vëllimi III.
 8. Kosovar BASHA, Shtypi shqiptar në RSF Jugosllavi.
 9. Emine HAJDARI & Arben HAJDARI, Paionët dhe Paionia te autorët antikë.
 10. *Diaspora shqiptare dhe çështja e Kosovës, 1912-2008* (materiale nga Konferenca Shkencore (3 dhe 4 qershor 2025).
 11. Luan TETAJ, Masakrat serbo-malazeze ndaj shqiptarëve të Kosovës sipas dokumenteve diplomatike shqiptare (1912-1929).
 12. Revista shkencore: *Kosova 50*.

VEPRIMTARIA E KËSHILLIT DREJTUES TË INSTITUTIT TË HISTORISË “ALI HADRI” PËR VITIN 2025

Gjatë vitit 2025, në cilësinë e Kryesueses së Këshillit Drejtues të Institutit të Historisë “Ali Hadri”, kam udhëhequr gjithsej 16 mbledhje të rregullta, në të cilat janë trajtuar dhe miratuar çështje me rëndësi të veçantë për funksionimin e Institutit. Në kuadër të këtyre mbledhjeve janë realizuar hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore:

- **Rregullorja mbi punën e Këshillit Drejtues të Institutit të Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë**, e cila përcakton mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe procedurat e vendimmarrjes së Këshillit Drejtues.
- **Rregullorja për normën, mbinormën, punët shtesë dhe kompensimin për mbinormën dhe punët shtesë**, që rregullon normën, mbinormën dhe kompensimin për punët shtesë të punonjësve të Institutit.

- **Rregullorja për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punonjësve shkencorë dhe hulumtues**, e cila përcakton kriteret, afatet dhe procedurat e avancimit dhe punësimit në Institutin e Historisë.
- **Rregullorja për revistën shkencore “Kosova” dhe periodikët e Institutit**, një dokument që standardizon procesin editorial, kriteret e botimit dhe funksionimin e organeve redaktuese.

Viti 2025 ka qenë një periudhë e rëndësishme për rishikimin dhe konsolidimin e bazës rregullative të Institutit. Përmes 15 mbledhjeve të zhvilluara, Këshilli Drejtues ka miratuar dokumente të domosdoshme që garantojnë funksionimin e rregullt institucional, rrisin transparencën dhe forcojnë cilësinë e punës shkencore.

Në cilësinë e kryesueses, kam siguruar zhvillimin e rregullt të mbledhjeve, koordinimin e punës dhe zbatimin e vendimeve, në përputhje me mandatin ligjor të Këshillit Drejtues.

MARRËVESHJE DHE MEMORANDUME BASHKËPUNIMI TË INSTITUTIT TË HISTORISË “ALI HADRI” GJATË VITIT 2025

Gjatë vitit 2025, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, në kuadër të veprimtarisë së tij kërkimore-shkencore, ka vazhduar të forcojë dhe zgjerojë bashkëpunimin me institucione shkencore dhe arsimore brenda dhe jashtë vendit. Gjatë vitit 2025, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, ka arritur të zgjerojë rrjetin e partnerëve të tij vendorë dhe ndërkombëtarë. Këto marrëveshje dhe memorandume krijojnë bazë të rëndësishme për avancimin e kërkimeve shkencore, si dhe për forcimin e bashkëpunimit akademik në rajon dhe më gjerë. Si rezultat i këtyre angazhimeve, gjatë këtij viti janë nënshkruar disa marrëveshje dhe memorandume bashkëpunimi, të cilat paraqiten më poshtë:

Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Institutit Albanologjik - Prishtinë, Institutit të Historisë “Ali Hadri” dhe Institutit Pedagogjik të Kosovës

Kjo marrëveshje synon zhvillimin e projekteve të përbashkëta në fushën e albanologjisë, historisë dhe pedagogjisë, si dhe shkëmbimin profesional ndërmjet studiuesve të këtyre institucioneve. Theksi i veçantë është vënë në

bashkëpunimin multidisiplinar dhe realizimin e aktiviteteve akademike dhe shkencore.

Memorandum bashkëpunimi me Institutin e Historisë së Turqisë Türk Tarih Kurumu

Ky memorandum paraqet zgjerim të bashkëpunimit ndërkombëtar, duke synuar shkëmbimin akademik, realizimin e projekteve të përbashkëta, organizimin e konferencave dhe publikimin e studimeve të përbashkëta në fushën e historisë.

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Institutit të Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë dhe Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Marrëveshja ka për qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, me theks të veçantë në: zhvillimin e kërkimeve shkencore dhe projekteve të përbashkëta, qasjen, hulumtimin dhe trajtimin profesional të dokumenteve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, organizimin e aktiviteteve akademike të përbashkëta, shkëmbimin e dokumentacionit arkivor, si dhe publikimin e rezultateve në botime shkencore.

Memorandum bashkëpunimi me Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Memorandumi ka për qëllim nxitjen, mbështetjen dhe zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta me interes të ndërsjellë, përfshirë projektet kërkimore, konferencat shkencore dhe aktivitete të tjera akademike që kontribuojnë në studimet historike dhe shkëmbimet ndër-institucionale.

Marrëveshja e bashkëpunimit me Qendrën për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Kulturës së Pakicave të Malit të Zi

Kjo marrëveshje synon forcimin e bashkëpunimit në fushën e studimeve historike dhe kulturore, me fokus të veçantë ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të pakicave. Palët janë dakorduar të zhvillojnë projekte të përbashkëta dhe aktivitete që kontribuojnë në mirëkuptimin ndërkulturor.

Memorandum bashkëpunimi me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës

Ky memorandum synon krijimin e një platforme bashkëpunimi në fushën e dokumentacionit historik, digjitalizimit të materialeve dhe qasjes në resurset bibliografike, duke lehtësuar punën kërkimore të studiuesve të Institutit.

Memorandum bashkëpunimi me Bibliotekën e Qytetit të Preshevës “Mehmet Jusufi”

Qëllimi i këtij memorandumi është shkëmbimi i botimeve, mbështetja e projekteve kërkimore dhe lehtësimi i qasjes në burime që lidhen me historinë dhe kulturën shqiptare në Luginën e Preshevës.

Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Universitetit Shtetëror të Tetovës dhe Institutit të Historisë “Ali Hadri”

Ky memorandum ka për qëllim zhvillimin e bashkëpunimit akademik dhe kërkimor përmes projekteve shkencore të përbashkëta, shkëmbimit të ekspertizës profesionale, organizimit të konferencave dhe publikimeve të përbashkëta, si dhe nxitjes së bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e historisë dhe shkencave shoqërore.

Memorandum bashkëpunimi me Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri

Ky memorandum synon të forcojë bashkëpunimin shkencor në fushën e studimeve mbi periudhën e komunizmit, duke përfshirë shkëmbimin e dokumentacionit arkivor, realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore, organizimin e aktiviteteve shkencore dhe botimin e studimeve të ndërsjella.

Memorandum bashkëpunimi me Qendrën për Kërkime të Historisë Moderne dhe Bashkëkohore – Tuzëll

Memorandumi i bashkëpunimit me Qendrën për Kërkime të Historisë Moderne dhe Bashkëkohore – Tuzëll ka për qëllim vendosjen dhe forcimin e bashkëpunimit institucional, në funksion të zhvillimit të kërkimeve shkencore në fushën e historisë moderne dhe bashkëkohore, shkëmbimit të përvojave akademike, realizimit të projekteve të përbashkëta kërkimore, organizimit të aktiviteteve shkencore (konferenca, tryeza të rrumbullakëta, ligjërata), si dhe bashkëpunimit në botime shkencore dhe shkëmbim të botimeve të dy institucioneve

TË ARRITURAT TJERA GJATË VITIT 2025

Digjitalizimi i botimeve të Institutit

Gjatë vitit 2025, Instituti i Historisë ka përfunduar me sukses digjitalizimin dhe sistemin e përmbledhjeve me punime nga aktivitetete shkencore - botime të Institutit. Një ndër arritjet kryesore të këtij viti është përfundimi me sukses i procesit të skanimit, përpunimit dhe publikimit të 28 përmbledhjeve me punime nga aktivitetete shkencore, përfshirë: konferenca, simpoziume dhe tryeza shkencore. Ky proces është realizuar në disa faza kryesore: Identifikimi dhe grumbullimi i materialeve; Skanimi dhe digjitalizimi; Përpunimi teknik dhe redaktimi i materialeve; Sistemimi tematik dhe kronologjik i materialeve. Të gjitha përmbledhjet janë të publikuara online në platformën: <https://konferenca.al/ih-rks>

Pasurimi i Bibliotekës së Institutit me tituj të rinj

Gjatë vitit 2025, prioritet për Institutin e Historisë ka qenë pasurimi i Bibliotekës me tituj të rinj, duke kontribuar ndjeshëm në zgjerimin e fondit të literaturës shkencore. Gjatë këtij viti, Biblioteka e Institutit është pasuruar me afërsisht 500 libra të rinj, të cilët përfaqësojnë fusha të ndryshme të historisë, albanologjisë, shkencave shoqërore dhe disiplinave të tjera ndihmëse. Donacionet institucionale përbëjnë pjesën më të madhe të librave të përfituar. Ndër institucionet dhuruese janë: *Logos-A; Instituti i Historisë i Turqisë dhe Instituti Albanologjik-Prishtinë*. Një pjesë tjetër e librave është blerë gjatë Panairit të Librit në Tiranë. Pasurimi i Bibliotekës në vitin 2025 përfaqëson një investim të rëndësishëm në mbështetje të veprimtarisë kërkimore-shkencore, duke garantuar qasje më të gjerë në literaturë të përditësuar dhe burime të rëndësishme për zhvillimin e studimeve në fushën e historisë.

Dërgimi i botimeve të Institutit në institucione shkencore dhe diplomatike

Gjatë vitit 2025, Instituti i Historisë ka vijuar me politikën e tij të shpërndarjes së botimeve shkencore me qëllim rritjen e qasjes, bashkëpunimit institucional dhe promovimit të veprimtarisë botuese. Në këtë kuadër, është realizuar dërgimi i një sasive të konsiderueshme të botimeve të Institutit në një sërë institucionesh brenda dhe jashtë vendit. Procesi i shpërndarjes ka përfshirë këto kategori institucionale:

-Bibliotekat e institucioneve shkencore - kërkimore dhe ato të arsimit të lartë, duke përfshirë qendra studimore që operojnë në fushën e historisë, albanologjisë dhe shkencave sociale. Nga ky proces kanë përfituar: Biblioteka e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Bibliotekat e Institutit Yunus Emre (*Fojnitcë, Mostar, Pejë, Podgoricë, Prishtinë, Prizren, Sarajevë, Shkodër, Shkup, Tiranë*), Staf i Departamentit të Antropologjisë-UP; Biblioteka e Fakultetit Filozofik-UP; Staf i Departamentit të Historisë-UP; Biblioteka dhe stafi i Institutit Albanologjik-Prishtinë; Biblioteka e Institutit Pedagogjik; Biblioteka dhe stafi i Institutit të Historisë-Tiranë; Biblioteka e Institutit të Historisë-Ankara; Biblioteka e Fakultetit “Aleksandër Xhuvani” - Elbasan; Biblioteka e Fakultetit të Edukimit; Biblioteka e kazermës së FSK-Istog; Biblioteka e LOGOS-it; Biblioteka e Njesisë për Trashëgimi dhe Muze në Ferizaj; Biblioteka “Meimet Jusufi” - Preshevë; Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore-Gjilan; Qendra e Paraburgimit-Prishtinë; “Biblioteka e Shoqatës së Familjeve të Dëshmoreve, Invalidëve dhe Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”-dega Malishevë.

-Institucionet e arsimit të ulët dhe të mesëm. Nga ky proces kanë përfituar: Gjinnazi “Hamdi Berisha” - Malishevë; Gjinnazi “Zenel Hajdini” - Gjilan; SHFMU “Naim Frashëri” - Vushtrri; SHFMU “Azem Galica” - Grabanic; SHFMU “European School of Kosova”; SHFMU “Hasan Prishtina” - Mitrovicë; “Kosovo Leadership Academy”; “Bibliotekat e shkollave shqipe në Malin e Zi”; SHFMU “Hilmi Hoti” - Carallukë (Malishevë); SHFMU “Mejdi Xhaferi” - Ferizaj; SHFMU “Remzi Ademaj” - Prizren; SHFMU “Abetarja” - Softaj-Ferizaj; SHFMU “Dy Dëshmorët” - Talinoc i Muhaxhirëve-Ferizaj; SHFMU “Pavarësia” - Prishtinë; “Biblioteka e Shoqatës Bytyqi”.

-Ambasadat dhe konsullatat e Republikës së Kosovës (*dhuruar Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës*), botimet e Institutit u janë dërguar për të mbështetur aktivitetet kulturore, promovimin e trashëgimisë historike dhe përfaqësimin e vlerave akademike të vendit në arenën ndërkombëtare.

Dërgimi i botimeve gjatë vitit 2025 ka kontribuar në: forcimin e lidhjeve ndërinstitucionale dhe bashkëpunimeve akademike; krijimin e një rrjeti më të gjerë shpërndarjes së botimeve të Institutit. Të tri fushat e mësipërme: digjitalizimi, pasurimi i Bibliotekës dhe shpërndarja e botimeve, përbëjnë shtylla të rëndësishme të zhvillimit institucional të vitit 2025. Ato dëshmojnë për përkushtimin e Institutit të Historisë për të forcuar infrastrukturën shkencore,

promovimin e kërkimit akademik dhe për të rritur rolin e Institutit si qendër kombëtare e studimeve në fushën e historisë.

HULUMTIMET NË ARKIVA KOMBËTARE E NDËRKOMBËTARE

Punonjësit shkencorë dhe hulumtues të Institutit të Historisë “Ali Hadri”, gjatë këtij viti, në kuadër të projekteve kolektive dhe atyre individuale kërkimore-shkencore, kanë hulumtuar nëpër arkiva vendore si dhe ato jashtë vendit si:

- Frashër Demaj ka hulumtuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave në Tiranë dhe ka sjellë 6554 faqe dokumente.
- Luan Tetaj ka hulumtuar në Arkivin Historik të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë, Arkivin Qendror Shtetëror dhe Bibliotekën Kombëtare në Republikën e Shqipërisë, dhe ka sjellë 1052 faqe dokumente.
- Shkodran Imeraj ka hulumtuar në Arkivin Historik të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë, Arkivin Qendror Shtetëror dhe Bibliotekën Kombëtare në Republikën e Shqipërisë. Ai ka sjellë 1814 faqe dokumente dhe 39 numra në PDF të gazetës Rilindja.
- Bedri Muhadri ka hulumtuar në Arkivin Qendror Shtetëror në Republikën e Shqipërisë dhe ka sjellë 1029 faqe dokumente.
- Kosovar Basha ka hulumtuar në Arkivin Historik të Dubrovnikut dhe ka sjellë 328 faqe dokumente.
- Fidan Zeneli ka hulumtuar në Arkivin Historik të Dubrovnikut dhe ka sjellë 609 faqe dokumente.
- Donika Avdulli ka hulumtuar në Archiwum Akt Nowych (ANN) [Arkivi i Akteve të Reja]. Varshavë – Poloni dhe ka sjellë 800 faqe dokumente.
- Donika Avdulli ka hulumtuar në Archiwum Ministerstwa Spraw Zagranicznych (AMSZ) - [Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme] Varshavë – Poloni dhe ka sjellë 700 faqe dokumente.

PJESËMARRJA NË KONFERENCA DHE SIMPOZIUME SHKENCORE, KOMBËTARE E NDËRKOMBËTARE

Punonjësit shkencorë dhe hulumtuesit e Institutit të Historisë “Ali Hadri” kanë marrë pjesë në një sërë aktivitetesh shkencore, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, si: Konferenca Shkencore: “Transformimet dhe zhvillimi i qendrave urbane në trevat shqiptare gjatë Antikitetit të Vonë dhe Mesjetës”, Prishtinë; “Identitete religjioze në trojet shqiptare nga Mesjeta deri në rënien e Perandorisë Osmane”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë - Instituti i Historisë-Tiranë & Instituti i Historisë “Ali Hadri”; “Konferenca e IX Mbarëkombëtare të Arkivistikës”, Shën Mitër, Kalabri; Kongresi i 5-të për Gjeografinë, Artin, Kulturën, Historinë dhe Folklorin, Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan; “Konferenca Shkencore Ndërkombëtare: “Kosova dhe Diplomacia Ndërkombëtare: Histori, sfida dhe perspektiva (fundi i shek. XX dhe fillimi i shek. XXI)”, Instituti i Historisë “Ali Hadri” Prishtinë, Instituti Albanologjik dhe Departamenti i Historisë i Universitetit të Prishtinës; Konferenca shkencore: “80 Vite Pas Luftës së Dytë Botërore: përballë Popullzimit dhe Ekstremizmit të Ri” Organizuar nga Universiteti Evropian i Tiranës - UET Press, në bashkëpunim me Fondacionin Friedrich-Ebert-Stiftung, Tiranë; Konferenca shkencore: “Dimensioni Historik i Kufijve të Kosovës nga Antika deri në Kohën bashkëkohore”, Instituti i Historisë “Ali Hadri” & Instituti Albanologjik/ Prishtinë; Konferenca shkencore: Bajram Curri në Lëvizjen kombëtare, ASHAK Prishtinë, Konferenca shkencore: “Studimet Albanistike te sllavet e jugut”, ASHAK Prishtinë, Konferenca shkencore: “Diaspora Shqiptare dhe çështja e Kosovës 1912 - 2008”, Konferenca Shkencore: “Kriza Lindore 1875-1878 dhe Shqiptarët”, Konferenca shkencore: “Sistemi republikan në Shqipëri përgjatë një shekulli”; Tryeza shkencore: “Ballafaqimi më të kaluarën: burimet, programet dhe pedagogjia (1990-1999)”; Tryeza Shkencore: “Shemsettin Sami Frashëri dhe lëvizjet moderne turko-shqiptare”; Libraries in the Ottoman World, organised by Department of Near and Middle Eastern Studies Faculty of Arts, Humanities and Social Sciences, Arts Building, Trinity College, Dublin, Irlandë; Konferenca shkencore “CENTURZ OF WORLD CATAclyms: War Crimes and Genocide in Bosnia and Hercegovina in the 20th Century”; Turkologentag 2025 <https://turkologentag.uni-mainz.de/programme/>; Konferenca shkencore “Java e albanologjisë 16/2025”, Prishtinë; Konferenca Shkencore Ndërkombëtare 100 vjet nga Republika Par-

lamentare Shqiptare (1925-1928), Elbasan; Konferenca shkencore: “Kosova gjatë shekullit XIX: një vështrim mbi dinamikat sociale”, organizuar nga Instituti Albanologjik, Prishtinë; *Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Vakefi te shqiptarët: histori-trashëgimi-perspektiva”*, organizuar nga Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame; UP, Seminari XLIII Ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare.

BOTIMET NË REVISTA KOMBËTARE E NDËRKOMBËTARE

Punonjësit shkencorë dhe hulumtuesit e Institutit të Historisë “Ali Hadri”, gjatë këtij viti, e kanë prezantuar punën e tyre shkencore në disa revista shkencore kombëtare e ndërkombëtare, si në: Kosova (Prishtinë); Studime Historike (Tiranë); Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave historike (Prishtinë); HISTORIJSKI POGLEDI HISTORICAL VIEWS; Historical Views no. 15 <https://pogledi.cimoshis.org/>; East European Historical Bulletin, Droho-bych E Ivan Franko State Pedagogical University, Ukraine, <https://eehb.dspu.edu.ua/>; West Bohemian Review <https://wbhr.cz/index.php/issues>; Bulgarian Historical Review: <https://doi.org/10.71069/BHR1.25.IGDA06>; Polityczny ład na Bałkanach - czynniki stabilizujące i destabilizujące, Kraków, 23-24 czerwca 2025]. Krakov, 23-24 qershor 2025; Konferenca Interdyscyplinarna SDNH, Chęciny - Europejskie Centrum Edukacji Geologicznej], Data: 4-6 prill 2025, Organizatorët Shkolla Doktorale e Shkencave Humane - Universiteti i Varshavës; Historijski Pogledi/Historical Views god VIII, Br. I 4/ VOL. VIII, No. 14, 1-575, Tuzla 2025 (}historijski pogledi br. 14 // 1-1 historical Views no. 14 - Casopis “Historijski 12ogledi” // Journal “Historical views”; https://doi.org/10.52259/historijski_pogledi.2025.8.14.392.

Teuta SHALA-PELI